



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E BRENDSHME**  
**SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.**  
**DEPARTAMENTI JURIDIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sisteme Vëzhgimi”**

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
31625000-3-Alarme anti-vjedhje dhe anti-zjarr
- 35125300-2- Kamera Sigurie
- 32333200-8 - Kamera video
- 
- **VLERA E FONDIT LIMIT:** 14,366,491.67(Katermbedhjetë milion e treqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e nentëdhjetë e një pik gjashtedhjetë e shtatë ) **LEK PA TVSH**
- Sigurimi i ofertës 2% 287,329.83(dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njetzet e nente pik tetëdhjetë e tre) lekë e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.** ,ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit Nr. Prot 725 ,datë 09.06.2025, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **“Sisteme Vëzhgimi”** për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A.

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

#### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: *“Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,* Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera përlogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se vlera përllogaritur të fondit limit sipas parashikimeve të pikes 2b të Nenit 43 të VKM.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”ose ekuivalent;
- b) ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”ose ekuivalent;
- c) ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”ose ekuivalent;
- d) ISO 20000-1 « Per teknologjine e informacionit » -Menaxhimin e shërbimit ose ekuivalent
- e) ISO 27001 ” Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalent

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipercituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë. Plotesimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

**ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** - Ky standard është i nevojshëm që furnizuesi të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis. ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standard është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë. është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**ISO 20000-1 « Per teknologjine e informacionit » -Menaxhimi i shërbimit** është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.

Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efikase dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” ShA. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikatat më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

**ISO 27001 ”Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”**- Ky standart është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e kërkesave të sigurisë në ruajtjen dhe menaxhin e informacionit . AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 27001 pas ofron mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike dhe rrjedhjeve të të dhënave, Besueshmëri më e madhe për klientët dhe partnerët, Përshtatje me kërkesa ligjore dhe kontraktuale, Përmirësim i menaxhimit të rreziqeve, Rritje e reputacionit të organizatës

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për produktet sipas tabelës me poshte. Operatorët ekonomikë pjesëmarrësduhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për furnizimin/suportin e pajisjeve që do të përdoren për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë për të gjitha pajisjet si më poshtë:

| NR. | EMERTIMI                                  |
|-----|-------------------------------------------|
| 1.  | NVR (NETWORK VIDEO RECORDER) ME 4 KANALE  |
| 2.  | NVR (NETWORK VIDEO RECORDER) ME 16 KANALE |
| 3.  | KAMERA E JASHTME ME NGJYRA 24/7           |
| 4.  | KAMERA E BRENDSHME ME NGJYRA 24/7         |
| 5.  | KAMERA E JASHTME INTELIGJENTE             |
| 6.  | KAMERA E BRENDSHME INTELIGJENTE           |

|     |                                                           |
|-----|-----------------------------------------------------------|
| 7.  | KAMER TRUPI “ BODY CAMER”                                 |
| 8.  | PoE SWITCH 5 PORTA                                        |
| 9.  | PoE SWITCH 9 PORTA                                        |
| 10. | SWITCH 5 PORTA I THJESHT 10/100/1000                      |
| 11. | PANELI ALARMIT                                            |
| 12. | EKSPANDER WIRELESS                                        |
| 13. | TASTIER KOMANDIMI WIRELESS                                |
| 14. | PULT KOMANDIMI PER PANELIN E ALARMIT                      |
| 15. | SENSORË LËVIZJE (VOLUMETRIK) ME TELA I BRENDSHËM          |
| 16. | SENSORË LËVIZJE (VOLUMETRIK) WIRELESS BRENDSHËM           |
| 17. | SENSORE DEDEKTIMI TYMI ME TELA I BRENDSHËM                |
| 18. | SENSORE DEDEKTIMI TYMI WIRELESS I BRENDSHËM               |
| 19. | SIRENË                                                    |
| 20. | AKSES KONTROLL                                            |
| 21. | AKSES KONTROLL ME NJOHJE FYTYRE “FACE ACCESS<br>TERMINAL” |
| 22. | MONITOR                                                   |
| 23. | UPS 1000VA                                                |
| 24. | TRA PARKIMI                                               |
| 25. | TRIPODË                                                   |

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt

prokurimi sipas tabelës me poshte, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

| NR. | EMERTIMI                                                  |
|-----|-----------------------------------------------------------|
| 1.  | NVR (NETWORK VIDEO RECORDER) ME 4 KANALE                  |
| 2.  | NVR (NETWORK VIDEO RECORDER) ME 16 KANALE                 |
| 3.  | KAMERA E JASHTME ME NGJYRA 24/7                           |
| 4.  | KAMERA E BRENDSHME ME NGJYRA 24/7                         |
| 5.  | KAMERA E JASHTME INTELIGJENTE                             |
| 6.  | KAMERA E BRENDSHME INTELIGJENTE                           |
| 7.  | KAMER TRUPI “ BODY CAMER”                                 |
| 8.  | POE SWITCH 5 PORTA                                        |
| 9.  | POE SWITCH 9 PORTA                                        |
| 10. | SWITCH 5 PORTA I THJESHT 10/100/1000                      |
| 11. | PANELI ALARMIT                                            |
| 12. | EKSPANDER WIRELESS                                        |
| 13. | TASTIER KOMANDIMI WIRELESS                                |
| 14. | PULT KOMANDIMI PER PANELIN E ALARMIT                      |
| 15. | SENSORË LËVIZJE (VOLUMETRIK) ME TELA I BRENDSHËM          |
| 16. | SENSORË LËVIZJE (VOLUMETRIK) WIRELESS BRENDSHËM           |
| 17. | SENSORE DEDEKTIMI TYMI ME TELA I BRENDSHËM                |
| 18. | SENSORE DEDEKTIMI TYMI WIRELESS I BRENDSHËM               |
| 19. | SIRENË                                                    |
| 20. | AKSES KONTROLL                                            |
| 21. | AKSES KONTROLL ME NJOHJE FYTYRE “FACE ACCESS<br>TERMINAL” |
| 22. | MONITOR                                                   |
| 23. | UPS 1000VA                                                |
| 24. | TRA PARKIMI                                               |
| 25. | TRIPODË                                                   |

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6,

gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Katalogët e prodhuesit janë burimi zyrtar dhe autentik për të dhënat teknike të pajisjeve. Ato mundësojnë krahasimin e drejtë të ofertës me **specifikimet teknike të prokurimit**. Përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi sigurojnë që informacioni të jetë **i saktë, i qartë dhe i kuptueshëm**, duke shmangur keqinterpretimet teknike gjatë vlerësimit të ofertave. Fakti që katalogët duhet të jenë **të verifikueshëm në faqen zyrtare të prodhuesit**, rrit besueshmërinë dhe e bën ofertën të **kontrollueshme dhe objektive** për çdo palë. Përdorimi i dokumentacionit origjinal të prodhuesit ndihmon në **ruajtjen e standardeve ndërkombëtare**, duke garantuar cilësinë e produkteve që do të furnizohen.

**2.3.5** Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar për periudhën e 3 muajve të fundit, të paktën 9 (nente) persona të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar vërtetuar me listepagesat E-sig, si me poshte:

- Të paktën 2 (dy) inxhinierë të profileve Elektronik/Elektrik/Telekomunikacioni/informatike për të cilët duhet të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome sipas ligjit;
- Të paktën 1(një) punonjës të pajisur me Certifikatë për Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute(P M I) ose ekuivalente;
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave të ofertuar;
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të alarmeve të ofertuar;
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të aksesit kontrollit të ofertuar;

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Diploma;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën 3 muajt e fundit.

**Shënim: AK do të lejoj që 1(një) punonjës të ketë më shumë se një Certifikim.**

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure

### **Konkretisht:**

- a) 2 (dy ) inxhinierë të profileve Elektronik/Elektrik/Telekomunikacioni Eshtë kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimit të furnizimit dhe procesit të instalimit të sistemeve të kamerave, alarmit, aksesit etj të cilat janë pajisje elektronike dhe do të funksionojnë nëpërmjet energjisë elektrike.
- b) (një) punonjës të pajisur me Certificate per Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute(P M I) ose ekuivalente; Është kërkuar si kriter si garanci se operatori ekonomik ka në staf një person të certifikuar dhe me eksperiencë që do të jetë i angazhuar në menaxhimin e kontratave që do të lidhen në kuadër të marrëveshjes kuadër .
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave te ofertuar; - Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në instalimin e sistemeve të kamerave ndaj duhet të jenë të trajnuar nga prodhuesi i produkteve që do të instalojnë në mënyrë që instalimet të jenë korrekte dhe mos të ketë problematika.
- d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të alarmeve te Ofertuar- Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në instalimin e sistemeve të alarmeve ndaj duhet të jenë të trajnuar nga prodhuesi i produkteve që do të instalojnë në mënyrë që instalimet të jenë korrekte dhe mos të ketë problematika.
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit te akses kontrollit te ofertuar;- Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në instalimin e sistemeve të aksesit ndaj duhet të jenë të trajnuar nga prodhuesi i produkteve që do të instalojnë në mënyrë që instalimet të jenë korrekte dhe mos të ketë problematika.

**Në lidhje me kërkesat e parashikuara në pikat 2.3.5 të kapacitetit Teknik për punonjësit e certifikuar nga prodhuesit e sistemeve të kamerave/alarmeve/akses kontrollit të ofertuar gjykojmë që ky është një kriter I domosdoshëm pasi kemi të bëjmë me një procedure furnizim/vendosje malli sistemesh sigurie të teknologjisë së lartë që punojnë 24/7 dhe kanë një rëndësi të vecantë pasi instalohen në institucionet shtetërore që Illyrian guard sh.a merr në ruajtje sipas fushës së përgjegjësisë ligjore. Certifikimi nga prodhuesi është garanci për**

AK se këto sisteme do të instalohen nga persona të trajnuar, me ekperiencë dhe që e nohin produktin dhe mund ti japin zgjidhje cdo problematike që mund të dalë gjatë fazës së instalimit, konfigurimit, integritit në sistemet ekzistuese dhe nevojës për riparim gjatë periudhës së garancisë. Në tregun shqiptar larshmëri produktesh sigurie nga prodhuesit ndërkombëtarë ndaj nuk kemi cenim apo ngushtim konkurrence.

E vetmja kërkesë është që personi që do të kryejë instalimin të jetë I trajnuar për produktin që do të instalojë nga prodhuesi. Kjo është një kërkesë minimale që e disponon cdo shoqëri që ofron shërbimin e instalimit ndaj AK gjykon se nuk kufizon konkurrencën. Nuk kemi të bëjmë me produkte të përgjithshme apo standarte ku të pranohen certifikimet bazë që lëshojnë institucionet por me produkte teknologjike të avancuara që do të kryejnë një funksion specifik dhe të një rëndësie shumë të vecantë.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të disponojë te pakten **2 (dy) automjete** për realizimin e instalimeve, për të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpërmendura janë marrë me qera ofertuesi duhet të paraqesë ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 9, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

**Argumentimi:** Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mësipërme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

Duke marrë në konsideratë se për realizimin me sukses të kësaj procedure do të kryhen instalime në të gjithë vendin 2 automjete është numri minimal i nevojshëm që dëshmon aftësinë e operatorit

ekonomik për të bërë transportin e materialeve në pikat e montimit për të paktën 2 grupe pune cdo ditë.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë janë të reja.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja sepse: Sigurojnë performancë optimale dhe përputhen me specifikimet teknike. Garantojnë jetëgjatësi të gjatë dhe mirëmbajtje më të lehtë. Janë të certifikuara sipas standardeve më të fundit të cilësisë dhe sigurisë. Ofrojnë mbështetje teknike dhe akses në pjesë këmbimi. Kjo kërkesë nuk është vetëm formale, por thelbësore për cilësinë dhe besueshmërinë e furnizimit.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë kanë vite garanci aq sa është e përcaktuar nga AK në specifikimet teknike bashkelidhur.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor sepse: Garancia teknike është tregues i cilësisë së produktit. Një periudhë garancie e gjatë tregon se prodhuesi ka besim në qëndrueshmërinë dhe performancën e produktit të tij. Zvogëlon rrezikun e defekteve gjatë përdorimit. Gjatë periudhës së garancisë, çdo defekt mbulohet pa kosto për autoritetin, duke garantuar funksionim të pandërprerë. Siguron përputhje me kërkesat e kontratës. Respektimi i periudhës së garancisë sipas specifikimeve teknike është një kërkesë ligjore dhe teknike, dhe çdo devijim do të përbënte mospërputhje. Redukton kostot e mirëmbajtjes për autoritetin kontraktor. Gjatë periudhës së garancisë, mirëmbajtja dhe zëvendësimi i pjesëve defektoze mbulohet nga furnizuesi ose prodhuesi. Siguron qëndrueshmëri teknike. Një garanci afatgjatë siguron jetëgjatësi të investimit dhe qëndrueshmëri në funksionimin e sistemit apo pajisjes së blerë.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se instalimi i sistemit të kamerave dhe alarmit në një objekt të caktuar, do të kryhet sipas tabelës më poshtë, duke filluar nga marrja e kërkesës zyrtare të dërguar nga Autoriteti Kontraktor:

| Nr. | Aktiviteti që do të kryhet              | Nr i ditëve të punës për objekt në Tiranë | Nr. ditëve të punës për objekt jashtë Tirane |
|-----|-----------------------------------------|-------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1.  | FV Sistem vëzhgimi dhe alarmi 4 kanale. | 1                                         | 2                                            |

|    |                                          |   |   |
|----|------------------------------------------|---|---|
| 2. | FV Sistem vëzhgimi dhe alarmi 16 kanale. | 2 | 4 |
| 3. | FV Sinjalizim dhe kamera teke.           | 1 | 2 |
| 4. | FV Akses kontroll.                       | 1 | 2 |
| 5. | FV Akses kontroll me njohje fytyre.      | 1 | 2 |
| 6. | FV Tra Parkim.                           | 1 | 2 |
| 7. | FV Tripode.                              | 1 | 2 |

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se koha e reagimit dhe riparimit të defekteve, do të jetë brenda 48 orëve shtatë ditë të javës, duke filluar nga marrja e kërkesës zyrtare (shkresore ose e-mail) të dërguar nga Autoriteti Kontraktor. **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor sepse Reagimi i shpejtë dhe riparimi brenda 48 orëve siguron vazhdimësinë e punës së pajisjeve dhe shërbimeve, duke shmangur ndalesa të gjata që ndikojnë negativisht në funksionimin e autoritetit kontraktor.

Koha e shkurtër e reagimit rrit besimin në furnizuesin dhe siguron zgjidhje të shpejta për problemet teknike.

Ndërhyrjet e shpejta parandalojnë dëmtime të mëtejshme dhe reduktojnë nevojën për riparime më të shtrenjta.

Disponueshmëria 7 ditë në javë garanton që çdo problem do të trajtohet pa vonesa, pa marrë parasysh ditën apo orën.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Njësia e Prokurimit**